



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 3486/ Prot. Tiranë, më 25.10.2024
28

Nr. 227/2 Prot. Tiranë, më 25.10.2024

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 161, Datë 25/10 /2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDIHRIN E PËRBASHKËT NR. 112, DATË 05.07.2024,
“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2024 – 2025”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”,

URDHËROJ

1. Në kalendarin e miratuar sipas urdhrin të përbashkët nr.112, datë 05.07.2024, “Për miratimin e kalendarit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2024 – 2025”, në shtojcën nr.1, bëhen ndryshimet sa më poshtë:

Shtojca 1.

PERIUDHAT/DATAT

KREU II

Procedurat e Aplikimit dhe Regjistrimit të kandidatëve në Programet e Studimeve me Karakter Profesional, në Programet e Studimeve të Ciklit të Parë dhe në Programet e Integruara të Studimeve të Ciklit të Dytë

Referenca në Udhëzim	Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit	
	Ishte	Bëhet
Kreu II, pika I.1	8-9 tetor 2024	28-29 tetor 2024
Kreu II, pika I.2	9 tetor 2024	29 tetor 2024
Kreu II, pika J.2	Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në asnjë program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, në periudhën 10-25 tetor 2024. Sekretaritetë mësimore kryejnë regjistrimin e këtyre studentëve brenda datës 25 tetor 2024 në portalin UAlbania.	Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në asnjë program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, në periudhën 30.10.2024 – 08.11.2024. Sekretaritetë mësimore kryejnë regjistrimin e këtyre studentëve brenda datës 08 nëntor 2024 në portalin UAlbania.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Aurora BALI



Për Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtor i Përgjithshëm

Z. Arjan XHELI

